

Msc. Enkelejda SEJDINI (BALLA)

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë

MENDIMI ARKIVOR SHQIPTAR. PROBLEME DHE ZGJIDHJE TEORIKE – PRAKTIKE

Abstrakt: *Punimi që paraqesim ka në themel një tematikë që deri më sot është studiuar pak në arkivistikën shqiptare. Përpjekja e parë në fushën e mendimit arkivistik shqiptar është realizuar nga Dr. Kujtim Nuro “Aspekte të mendimit arkivor në Shqipëri 1506-1912”.*

Lindja e mendimit arkivor modern në gjysmën e parë të shek. XX-të nuk përjashton kurrsesi përplasjet ideore, se çfarë dubet kuptuar dhe kuptohet, gjatë procesit të zhvillimit historik me “dokument dhe format e ekzistencës, të mënyrës së ndërtimit, të mënyrës së ruajtjes dhe funksionet e tij. Për rrjedhojë mendimi arkivor shqiptar është i lashtë saqë “koncepti arkiv” njehsohej me vetë “dokumentin”.

Mendimi arkivor modern shqiptar si teori dhe praktikë institucionale, i ka paraprirë ngritjes institucionale shtetërore arkivore krahas institucionalizimit të shtetit shqiptar nga viti 1912 deri më sot.

Në periudhën 1912-1944 u hodhën themelet e mendimit arkivor në vendin tonë. Në këtë periudhë ashtu si praktika botërore “Arkivi” ka gjetur trajtim shkencor dhe institucional, dhe për shkak të domosdoshmërisë së komunikimit institucional kombëtar, ndërkombëtar dhe shoqëror, mendimi arkivor i kohës, shtronte si domosdoshmëri, ngritjen e kësaj veprimtarie mbi baza ligjore dhe të monitorueshme. E tërë historia e zhvillimit të arkivave në këtë periudhë ka gjetur trajtim të thellë dhe të ngjeshur historik në punimin “Historia e arkivave në Shqipëri” e Dr. Ivan Loli (Tiranë 1999).

Mbështetur në përvojën historike arkivore shqiptare dhe atë botërore, pas Luftës së Dytë Botërore, me vendosjen e një shteti të një natyre tjetër, mendimi arkivor nuk mbeti pas, dhe në funksion të komunikimit ndërdikasterial, me urdhëresë të Këshillit të Ministrave në vitin 1949 krijohet Arkivi i Shtetit me funksione të shumta në fushën e trajtimit të dokumentit “si kujtesa historike e kombit”.

Mendimi arkivor shqiptar i periudhës së shtetit të diktaturës, e të shoqërisë së mbyllur është trajtuar nga M. Pela në Manual arkivor të vitit 1984. Në këtë periudhë teoria dhe praktika arkivore shënon nivele të krabasuar me ato evropiane dhe arkivi shqiptar bëhet partner dhe bashkëpunues me mjaft arkiva evropiane. Mendimi arkivistik i periudhës

komuniste shtronte para organeve qendrore nevojën e ngritjes së kualifikimit të punonjësve në shkallë institucionale.

Pas viteve 1990 mendimi arkivor, në periudhën e përmbyseve shtetërore, ka kaluar dhe është gjendur para situatave ekzistencialiste, që si kudo dhe në fushën arkivore ekzistonte mundësia e asgjësimit. Mendimi arkivor i ka paraprirë këtyre situatave, dhe rrjedhojë e hapjes së shoqërisë “arkivat nga institucione të mbyllura e të frikshme” u shndërruan në “institucione të hapura në një shoqëri të lirë e të hapur” ku krabas funksioneve institucionale të ligjëruari, fillojë të luajë një rol të rëndësishëm, në funksion të shërbimit jo vetë institucional por edhe qytetar.

Fjalët kyçe: *Ligj arkivor, dokument, arkiv, bibliotekë-arkiv, muze-arkiv, fuqi prapavepruese*

ALBANIAN ARCHIVE THINKING. PROBLEMS AND THEORETICAL-PRACTICAL SOLUTIONS.

Abstract: *The paper I'm presenting is based on a topic that has so far been studied little in Albanian archivistics. The first attempt in the field of Albanian archival thinking was conducted by Dr. Kujtim Nuro on his PhD thesis “Aspects of Archival Thought in Albania 1506-1912”.*

The emergence of modern archival thought in the first half of the 20th century does not exclude the conceptual clashes, what should be understood and is understood during the historical development process with “documents and forms of existence, manner of construction, conservation mode and its functions. As a consequence, the Albanian archival thought is ancient, that the “archival concept” was the “document” itself.

Modern Albanian archival thinking as institutional theory and practice has preceded the establishment of an institutional archival state alongside the institutionalization of the Albanian state from 1912 until today.

In the period 1912-1944 the foundations of archival thought were laid in our country. In this period as well as in the world practice, the “Archive” has experienced scientific and institutional treatments, and due to the necessity of national, international and social institutional communication, the archival opinion of the time was a necessity, the establishment of this activity on legal and observable levels. The entire history of archive development in this period has found deep and concise historical treatment in the “History of Archives in Albania” and Dr. Ivan Loli (Tirana, 1999).

Based on the historical archival history of Albania and the world, after the second world war, with the establishment of a state of a different nature, archival thought was not left behind, and in the function of inter-ministerial communication, by the order of the Council of Ministers in 1949, of the State with multiple functions in the field of document handling “as

the historical memory of the nation”.

The archival Albanian opinion of the state of dictatorship and the closed society was dealt with by M. Pela in the “Archive Manual” of 1984. In this period, the theory and practice of archives marks levels comparable to the European ones and the Albanian archive became a partner and cooperative with many European archives. The communist-era archivistic’s opinion laid before the central bodies the need to raise the qualification of employees on an institutional scale.

After the 1990s, the archival thought, in the period of state overthrows, has passed and has been in existence before existentialist situations, as everywhere and in the archive field there was a possibility of annihilation. Archival thinking has preceded these situations, and as a result of the opening of the society “archives from closed and scary institutions” became “open institutions in a free and open society” where besides the institutionally legitimized functions they started to play an important role, in function of non-institutional but also a civil service.

Keywords: *Archival law, document, archive, library-archive, museum archive, retrospective power*

Hyrje

Mendimi arkivor shqiptar, nuk ka mbetur jashtë vëmendjes së studiuesve, të cilët në kohë të ndryshme kanë cekur dhe trajtuar probleme rreth mendimit arkivor, qoftë dhe me frymë përgjithësuese. Përpjekjen e parë studimore në fushën e mendimit arkivor shqiptar e ka realizuar studiuesi Kujtim Nuro në tezën doktrinale me temë *Aspekte të mendimit arkivor shqiptar në vitet 1506-1912*.

Mendimi arkivor shqiptar, si proces pjekjeje dhe formimi ka kaluar nëpër disa periudha:

a- Periudha e parë dhe më e rëndësishme, në shtrirjen e saj kohore, shumë shekullore i takon periudhës parainstitucionale e cila arrin deri në vitin 1949.

b- Faza e dytë e mendimit arkivor shqiptar, fillon me formimin e institucioneve të specializuara të shërbimit arkivor kombëtar në vitin 1949, me një udhëzim të posaçëm me nr. 21, datë 08.06.1949 të Këshillit të Ministrave, Arkivat në Shqipëri kanë më shumë se treçerekshkulli jetë si institucion.¹

Ky periodizim i mendimit arkivor shqiptar në një farë mënyre përplasat me mendimin e shprehur se mendimi arkivor shqiptar i ka fillesat e tij në vitin 1912 (më 28.11) kur shënohet në historinë e kombit tonë “themelimi i shtetit të pavarur shqiptar”. Evident është një fakt ndoshta dhe shkencor, pasi studiuesi

¹ Shaban Sinani, *Arkivat të hapur në shoqëri të hapur*, fq. 22.

Shaban Sinani mendimin e tij e mbështet me faktin e lindjes së një institucioni të mirëfilltë arkivor, në kuadrin edhe si pjesë përbërëse të organeve shtetërore, institucion ky që nuk ka funksionuar me gjithë përpjekjet që janë bërë nga viti 1912-1949.

Mendimi arkivor shqiptar mbi konceptet “dokument”, “arkiv”.

Mendimi arkivor shqiptar ka vënë në balancë “dokumentin” si ekzistencë, njëherësh me “Arkivat”, të cilat lindin si kërkesë objektive e zhvillimit shoqëror². E lidhur me mendimin, gjuha regjistron përparimet në fushat apo aspektet shoqërore duke realizuar dhe shkëmbimet e mendimit në shoqëri. Domosdoshmëria e fiksimit të mendimeve, me anë të simboleve të artikuluar, çoi në lindjen e “dokumentit” i cili si koncept vjen nga latinishtja “documentum” shembull apo dëshmi. Dokumenti ka shoqëruar hap pas hapi zhvillimin e shoqërisë në tërë aspektet e saj dhe sasia forma, lëvizshmëria, objektivisht ka shtruar kërkesën e ruajtjes dhe administrimit të tyre. Mendimi arkivistik e ka vlerësuar, ashtu si dhe mendimi arkivistik ndërkombëtar, të vështirë ndarjen në kohë dhe hapësirë të konceptit “dokument” nga koncepti “Arkiv” dhe në të shumtën e trajtesave këto koncepte janë parë dhe studiuar pothuajse në unitet dhe funksione të njëri-tjetrit.

Mendimi arkivistik shqiptar pas vitit 1949 është ngritur në një shkallë të lartë, ku i vlerësonte dokumentet dhe arkivat si “kujtesa kombëtare”, e ka parë ligjin me fuqi “prapavepuese” e shtrirë kjo në kohë që nga fillimet e qytetërimit të hershëm ilir. Meqenëse dokumenti është *gjurma* e jetës shoqërore, si funksion i ruajtjes domosdoshmërisht lindi “vendruajtja” e dokumenteve e të gjitha natyrave dhe problematikave.

Mendimi arkivistik shqiptar e ka parë procesin e zhvillimit të dokumentit, si proces dinamik dhe sot “dokumenti” që buron nga administrata shtetërore nuk mund të kuptohet pa “Intestimin” dhe elementët përbërës të tij, si vendi, koha, thelbi i problemit, adresa, konfirmimi e bëjnë atë të qenësishëm. Duke qenë i tillë ai, dokumenti, realizon funksionin e tij në planin historik kombëtar, praktik dhe shoqëror.

Origjina e fjalës “Arkiv” vjen nga greqishtja e vjetër “Arheion” në të cilën kuptoheshin titujt e ndryshëm, me të cilët ishin lidhur të drejtat dhe detyrimet e zotëruesve të tyre. Vetëm në Mesjetë koncepti “arkiv” mori kuptimin teorik dhe praktik që ruan afërsisht sot si “vendi ku ruheshin dokumentet”³. Ashtu si dhe dokumenti, Arkivi ka evolucionin e tij në realitetin iliro – shqiptar. Ato i ndeshim në qytetet ilire në periudha të hershme ku ekzistonin bibliotekat, që ruanin jo vetëm librat por dhe dokumentet. Në shekujt XVII- XIX krahas bibliotekave,

² Mihallaq Pela, *Manual Arkivor*, fq. 6.

³ Po aty, fq. 7.

arkivave personale të klerit lindën bibliotekë-arkivat personale dhe familjare.

Mendimi arkivor shqiptar dhe arkivistika evropiane

Mendimi i arkivistikës shqiptare arrin në përfundimin se arkivat në Shqipëri kanë ndjekur të njëjtat rrjedha si dhe në shumë vende të tjera evropiane.⁴ Në mendimin arkivistik evropian ka ekzistuar kërkesa për të qartësuar se çfarë duhet të perceptojmë me konceptin “arkivë”.

Para shekullit XIX nuk ka pasur ndonjë debat serioz lidhur me origjinën, natyrën dhe vlerat e arkivave, pjesërisht sepse para Revolucionit Francez të vitit 1789 nuk kishte përqendrim të arkivave ekzistuese, të të gjitha zyrave qeveritare në një vendruajtje të vetme qendrore, të mbrojtur dhe të ruajtur, nuk ishin paracaktuar për kërkime historike, për rrjedhojë dhe të pashfrytëzuar nga qytetarët.⁵ Nga kjo periudhë historike në mendimin arkivistik botëror është diskutuar dhe debatuar për të qartësuar konceptet “arkivat”, “kultura” dhe “kombi” për të arritur në përfundimin se arkivat janë ato dokumente, të çdo institucioni publik ose privat, të cilat janë gjetur me vlerë të përhershme, për qëllime reference dhe kërkimi, që janë në ruajtje ose janë zgjedhur për tu ruajtur në një vendruajtje.⁶

Mendimi arkivor botëror i vlerëson “arkivat” si një mjet thelbësor për administrimin e shtetit apo “Arkivat” si bazë e menaxhimit të pronave, e duke shtuar se arkivat janë si themelet e kujtesës kolektive të popullit. Teoricienët e arkivistikës, duke e parë dokumentin si dëshmi e gjallë e përvojës së shkuar, e vlerësojnë arkivin si vendruajtje nga ku historianët me anë të dëshmimeve të vdekura, marrin jetë, apo vlerësimi se arkivat janë gjurmë të papunuara të jetës, që kurrë nuk do të kishin lënë gjurmë dhe se “arkiva është si një e çarë në pëlhurën e jetës së përditshme... plotësisht e fokusuar në disa momente të jetës së njerëzve të zakonshëm, që shumë rrallë janë shënuar në histori”.⁷

Në fillim të shek. XX teknika e thjeshtë e administrimit të dokumenteve filloi të marrë vlerë dhe veçori shkencore me specialistë e doktrina të formuara mbi një reflektim të përgjithshëm, të cilat erdhën duke u përsosur dhe e shndërruan arkivistikën në një disiplinë të rëndësishme shkencore.⁸

Mendimi arkivistik shqiptar, megjithëse këmbëngulës, e ka vlerësuar punën arkivore dhe fillesat e saj jo në pragun zero, por si një proces dinamik evolutiv nga “librari - arkiva, deri tek puna e administratës së Skënderbeut, ku funksiononin kancelaritë pra dhe arkivat, për t’u ngritur në një shkallë më të lartë

⁴ Ivan Loli, *Histori e Arkivave në Shqipëri 1912-1944*, fq. 3.

⁵ DPA, *Manual Arkivor* (përkthime artikujsh nga literaturë e huaj), fq. 30.

⁶ Po aty, fq. 31.

⁷ Po aty, fq. 14.

⁸ Ivan Loli, *Histori e Arkivave në Shqipëri 1912-1944*, fq. 3.

në epokën e rilindjes, ku lindin “ Arkiv-muzeume” ku dhe ruhej e tërë pasuria e kulturës shqiptare. Mendimi dhe praktika arkivore shqiptare, si veprimtari e organizuar, është e lidhur dhe e ndërvarur me veprimtarinë e shtetit të pavarur shqiptar, ku ka fillesat institucionalizimi i veprimtarisë arkivore dhe ekzistenca e sekretari-arkivave si hallka të strukturës dhe veprimtarisë shtetërore.⁹

Në vitet 1912-1944, kur u hodhën themelet dhe u formua shteti shqiptar, piqet dhe mendimi arkivor se “pjesë përbërëse e strukturave shtetërore janë dhe veprimtaria arkivore dhe arkivat”. Mendimi arkivor ka evoluar duke kapërcyer konceptin e “bibliotekë-arkiv” me funksionet ruajtëse, konceptin “arkiv-muzeum” dhe në fillim shek. XX, arkivi apo sekretari-arkivi konceptohet si institucion pjesë integrale dhe strukturë e organeve shtetërore.

Duke mos e shpërfillur përvojën botërore dhe teorinë e arkivistikës botërore, por dhe mbi traditën dhe trashëgiminë shqiptare mendimi arkivor shqiptar, për herë të parë gjatë veprimtarisë së qeverisë së Vlorës, në Kanunin e Përtashëm të Administratës Civile të Shqipërisë institucionalizoi krijimin e zyrave të sekretari-arkivave pranë të gjitha organeve shtetërore.¹⁰

Në dy 10-vjeçarët e gjysmës së parë të shek. XX-të mendimi arkivor bën një kapërcim cilësor. Është periudha kur veprimtaria arkivore në Shqipëri organizohet mbi baza ligjore. Është koha kur domosdoshmërisht kjo veprimtari, jo vetëm të vlerësohej, por ishte nevojë të hidhen themelet ligjore dhe normative, duke hartuar ligjin mbi Arkivat, mbi bazën e të cilit do të funksiononte veprimtaria e sekretari-arkivës si organ i specializuar për administrimin e dokumenteve. Në këtë periudhë për herë të parë është pjekur mendimi arkivor se produktet e veprimtarisë shtetërore, që materializohen në dokument i cili nuk vlerësohej si qëllim më vete, duhej ruajtur në një Institucion Qendror Arkivor me përmbajtje dhe veprimtari komplekse.

Përpos kësaj kërkesë, mendimi arkivor shënon dhe kulmin e pjekurisë dhe se ishte pjekur ideja se krahas sekretari- arkivave të ngritura pranë çdo institucioni, të ngrihej dhe një Arkiv Qendror (Ligji i vitit 1932) dhe disa arkiva të përqendruara të veprimtarive të llojeve të veçanta, dokumentet e të cilëve pasqyrojnë historinë kombëtare.

Me këto akte, mendimi arkivor shqiptar konsideron dhe vlerëson rëndësinë e dokumenteve dhe administrimin e tyre nga struktura të veçanta shtetërore, pasi siç janë shprehur mendimtarë si Donato Tamble “*Arkivi shënon fillesën e çdo aktiviteti. Mund të thuhet apo të afirmojmë se ndër pasuritë kulturore që lejojnë njohjen e së kaluarës arkivat zënë vendin më të rëndësishëm*”.¹¹

⁹ Po aty, fq.5

¹⁰ Po aty, fq. 5.

¹¹ Po aty, fq. 9.

Mendimi arkivor shqiptar në vitet 1945-1990

Në kushtet e shtetit ideokratik 1945-1990 mendimi arkivor shqiptar iu përshtat modelit të shtetit monopartiak, ndërtoi institucionet qendrore arkivore, sekretaritë dhe sekretari arkiva të natyrës së mbyllur, hermetike dhe të vëna nën kontroll të një shkalle tepër të lartë. Vendimet, urdhrat, ligjet e kësaj periudhe i përmbaheshin konceptit prapaveprues (retrospektivë) duke pasur nën ruajtje dhe administrim të tij dokumente që vijojnë kronologjikisht njëri-tjetrin për rreth 15 shekuj me radhë.

Duke marrë në konsideratë, mendimin arkivor ndërkombëtar, në gjysmën e dytë të shek. XX mendimi arkivor shqiptar ka arritur në përfundimin se “Arkivat” nga mënyra të konceptuarit si nocion me kuptim historik, që do të thotë se në to (arkivat) ruhen vetëm dokumente me vlerë historike, duke përjashtuar dokumentet me vlerë administrative dhe ajo që mbetet është vlerësimi i arkivit si vendruajtje e dokumenteve të llojit të veçantë. Mendimi arkivor ka bërë objekt diskutimi dhe analize se me “arkiv” duhet kuptuar “vendruajtje e dokumenteve” apo dhe vetë “dokumenti”.

I takon kësaj periudhe të zhvillimit të mendimit arkivor dhe përcaktimi korrekt, shkencor dhe modern i konceptit arkiv dhe saktësisht “arkiva” duhet kuptuar si tërësia e dokumenteve të krijuara nga veprimtaria e organeve shtetërore, ekonomike, shoqërore apo personave me rëndësi, që u ka përfunduar zgjidhja e problemit, që kanë vlerë shfrytëzimi dhe që i janë nënshtruar procesit të sistemit, “vendruajtja” apo “lokalet” ku ruhen dokumentet dhe institucionet që merren me administrimin e dokumenteve arkivore.¹²

Emërtesa e lartë politike në proceset e veprimtarisë së përditshme krijonte mal me dokumente jo vetëm të sferës civile, arsimore, kulturore, por dhe dokumente të karakterit të rezervuar pavarësisht përmbajtjes, prandaj shërbimi arkivor në tërësi ishte nën censurë. Mënyra se si ndërtoheshin vendruajtjet, paradhomat e sekretari-arkivës, mbyllja në tërësi, arkivat kishin hije të rëndë dhe shiheshin me frikë nga qytetarët.

Mendimi arkivor shqiptar i kësaj periudhe, me gjithë kufizimet që rridhnin nga “natyra e sistemit”, ka përcaktuar qartë njëherësh dhe konceptet teorike mbi dokumentin, teorinë e funksionimit të sekretarisë dhe sekretari-arkivës, ka ndërtuar modulet që përdoren në praktikën arkivore etj., duke mos neglizhuar punën për përgatitjen, kualifikimin e kuadrit që merret me punën e sekretari-arkivës.

Mendimi arkivor shqiptar pas viteve 1990

Pas ndryshimeve të mëdha demokratike, shoqëria shqiptare po bindet gjithnjë

¹² Mihallaq Pela, *Praktika arkivore në Shqipëri*, fq. 8.

e më shumë se ky institucion i mbyllur, si e tërë shoqëria, gati-gati i frikshëm, gjykuar nga vlerat që mendohej se ruheshin në të, por dhe sipas mendimit kolektiv apo të specialistëve sot, mund të themi se “në ato (arkiva) me të vërtetë qenkan ruajtur vlera të rralla prova të lashtësisë dhe vijueshmërisë kulturore të këtij populli”.

Mendimi arkivor shqiptar përshtat hap pas hapi zhvillimeve politike të ndryshimeve të reja institucionale dhe ka arritur të përpjekja për demokratizim dhe integrim të arkivave në rrafshin ligjor.¹³ Mendimi arkivor shqiptar i parë në këtë rrafsh, pra në planin ligjor, ka kapërcyer një prag dhe ka bërë hap cilësor duke bërë të mundur krijimin e hapësirave të nevojshme për mirëfunksionimin e sistemit arkivor jo si qëllim më vete por në shërbim të shoqërisë.

Në vitin 1993 ishte krijuar dhe konsoliduar mendimi se veprimtaria arkivore duhej rregulluar me ligj të posaçëm dhe iniciativa juridike u ndërmor nga punonjësit e arkivave. Koha iniconte mendimin nga koncepti “arkiv shtetëror” në konceptin “arkiv kombëtar”. Në këtë kuadër, mendimi arkivor për të kapërcyer “hijën e rëndë” me miratimin e ligjit mbi të drejtat dhe liritë e individit u përcaktua e drejta për informim si e drejtë ekzistenciale. Ligjërisht u njoh e drejta barazimtare e individit me institucionin për shërbim dhe informim arkivor. Kërkesë e situatave ekzistenciale, e kërkesave qytetare me ligj u hoq embargo e trashëguar për informacionin monopol ose sekret.

Arritjet e mendimit e të praktikës arkivore shqiptare kanë kushtëzuar në këtë periudhë një proces integrimi të përshpejtuar në institucionet arkivore ballkanike, evropiane e ndërkombëtare. Përveç marrëdhënieve të trashëguara me vendet si Italia, Austria, Turqia gjatë kësaj periudhe janë arritur marrëveshje bashkëpunimi dhe me arkivat e Vatikanit, Francës, Zvicrës, Ruisë, Bullgarisë, Malit të Zi, UNESCO-n. Mendimi arkivor shqiptar nuk e ka parë ngritjen e sistemit arkivor si qëllim më vete por praktika arkivore kombëtare ka arritur rezultate të prekshme.

Arkivi Qendror i Shtetit, si nyja më e rëndësishme e rrjetit arkivor kombëtar, aktualisht ka në dispozicion pasuri arkivore të sistemuara në 1,066 fonde arkivore, për të cilat ekzistojnë nivel të ndryshme mjetesish informimi dhe kërkimi (inventarë, skedarë, katalogë, tregues).

Përfundime

Mendimi arkivor shqiptar, gjatë procesit të lindjes, rritjes dhe pjekjes, nuk është qëllim më vete, por pjesë e procesit dhe lindjes së institucioneve arkivore, ai ka shërbyer si udhërrëfyes për mënyrën e ndërtimit praktik në realitetin e shtetbërjes në Shqipëri. Mendimi arkivor shqiptar është i herët, aq sa i lashtë është kombi

¹³ Shaban Sinani, *Arkiva të hapur në shoqëri të hapur*, fq. 8.

ynë, megjithëse kohë pas kohe ka njohur nuanca dhe modele të reja, duke pasur në themel teoritë historike mbi dokumentin dhe arkivin. Mendimin arkivor shqiptar nuk mund ta kuptosh, pa konsideruar praktikën, mendimin dhe përvojën botërore. Cilado të ketë qenë historia e evolucionit tonë politik kombëtar pas vitit 1912, mendimi arkivor shqiptar e ka vlerësuar arkivin, sekretari- arkivin, pjesë integrale e strukturave shtetërore. Falë mendimit arkivor shqiptar, Arkivi Shtetëror sot është pjesë integrale e rrjetit arkivor evropian dhe atij botëror.

Bibliografi:

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, *Manual Arkivor* (përkthime artikujsh nga literaturë e huaj), Tiranë, 2008.

Loli, Ivan, *Histori e Arkivave në Shqipëri 1912-1944*, Tiranë, 1999.

Pela, Mihallaq, *Manual Arkivor*, Tiranë, 1984.

Sinani, Shaban, *Arkivat të hapur në shoqëri të hapur*, Tiranë, 2002.

